



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 258, datë 21.12.2021

MBI

LICENCIMIN E SHOQËRISË “ALBANIAN ENERGY SUPPLIER 2” SH.P.K, NË
VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “d”, nenit 5, pika 1, gërma “d”, si dhe nenit 10, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 19, pika 1, gërma “a”, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 21.12.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 156/12 prot., datë 21.12.2021, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s me vendimin nr. 237, datë 26.11.2021, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k. në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5 vjeçar.
- ERE me shkresën nr. 6/26 prot., datë 26.11.2021, bëri njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga palët e treta (data 14.12.2021), nuk rezultoi të ketë të tilla lidhur me këtë aplikim.
- Shoqëria me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 474/2, datë 16.12.2021, ka përcjellë në ERE dokumentacion dhe informacion.
- Shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit për t’u pajisur me licencë në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike nga ERE, në zbatim të Aneksit A, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar.

- Dokumentacioni i këtij aplikimi është i plotësuar në zbatim të kërkesave të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, të ndryshuar, si më poshtë:
 - Formati dhe dokumentacioni për aplikim - neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”. **Plotësuar.**
 - Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor - neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”. **Plotësuar.**
 - Dokumentacioni financiar dhe fiskal - neni 9, pika 3, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”. **Plotësuar.**
 - Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike - neni 9, pika 4.7, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “f”, “h”, “I”. **Plotësuar.**
- Në lidhje me dokumentacionin e plotësuar pjesërisht:

neni 9, pika 2

- **gërma “e”** (struktura e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të shoqërisë, sipas pozicioneve dhe profileve përkatëse), shoqëria ka përcjellë në ERE strukturën e organizimit të saj, ku përfshihet administratori, përgjegjësi i nënstacionit, si dhe elektrikistët dhe ndihmës elektrikistët e nënstacionit, por në kuadër të kësaj licence, ajo duhet të përcjellë në ERE strukturën e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të saj, në përputhje me ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike.

neni 9, pika 4.7

- **gërma “e”** (sistemi IT i krijuar për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike apo marrëveshje me të tretët për vënien në dispozicion/përdorimin e këtij shërbimi) vlerësohet që t’i lihet kusht depozitimi në ERE i marrëveshjes përkatëse për përdorimin e platformës DAMAS, me fillimin e operimit.
- **gërma “g”** (dokumentacion që vërteton aftësinë e disponimit të zyrave përfaqësuese të furnizuesit, për shërbimet që do t’i ofrohen klientëve) duke qenë se afati i kohëzgjatjes së huapërdorjes së zyrave është i njëjtë me afatin e kontratës së qirasë, mbi bazën e së cilës është lidhur dhe kontrata e huapërdorjes dhe ky afat përfundon më 01.02.2024, periudhë kjo që nuk mbulon të gjitha vitet e licencimit të shoqërisë, shoqëria duhet të depozitojë kontratën e rinovuar jo më vonë se 1 (një) muaj pas rinovimit të saj.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Shoqëria “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k. të depozitojë në ERE brenda 1 (një) muaji nga marrja dijëni, strukturën e ndërtimit dhe funksionimit administrativ të saj, në përputhje me ushtrimin e veprimtarisë së furnizimit të energjisë elektrike.
3. Me fillimin e operimit, shoqëria “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k. të depozitojë në ERE sistemin IT.
4. Shoqëria “Albanian Energy Supplier 2” sh.p.k. të depozitojë në ERE kontratën e huapërdorjes të rinovuar jo më vonë se 1 (një) muaj pas rinovimit të saj (afati i përfundimit data 01.02.2024).
5. Mosplotësimi i kushteve të mësipërme përbën shkak për rishikimin e këtij vendimi.
6. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI